



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 5250 Prot.

Tiranë, më 31.03 2017

Lënda: Njoftim

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), në kuadër të masave për rritjen e sigurisë së bazave të të dhënave në Sistemin e Prokurimit Elektronik (në vijim “SPE”), sjell në vëmendje të Operatorët Ekonomikë sa më poshtë vijon:

1. Formati i lejuar për ngarkim në sistem gjatë procesit të dorëzimit të ofertave është **vetëm PDF**.
2. SPE nuk do të lejojë ngarkimin e folderave në formatin **ZIP/RAR** për arsye sigurie.
3. Madhësia e cdo dokumenti (file) të ngarkuar nuk duhet të jetë më shumë se **30 MB**, por nuk do të ketë limitim të numrin e tyre.
4. Emërtimet e cdo dokumenti (file) duhet të jenë **pa simbole të veçanta** (!,@,#,\$...etj).
5. Në seksionin e “Ngarko Ofertën Ekonomikë”, operatorët ekonomikë duhet të ngarkojnë **vetëm dokumentin që përmban** ofertën ekonomike të tyre, e cila do enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit.

Sa më sipër, APP njofton të gjithë Operatorët Ekonomikë që të marrin masat paraprake të nevojshme duke zbatuar pikat e sipërcituara para se të fillojnë me ngarkimin e dokumenteve në SPE.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti

